



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal off Kacanik

01Nr. 16-9094/2014

Kaçanik, 31.03.2014

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK			
I	Data	Vendi	
	02-04/14	Kaçanik	
	Numri	Shtojcë	
	01Nr.16-9094/14		

Në bazë të nenit 4 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, të Ligjit 04/L-110 për Tokën Ndërtimore, të nenit 12, 14 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

MBI BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT

I.

Me këtë Vendim, bartet e drejta e shfrytëzimit nga P. SH. Shoqëria Sportive "Lepenci" në Kaçanik në Pronë Komunale- Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, pasuria e paluajtshme dhe atë: parcela kadastrale nr. 0228-0, në sipërfaqe prej 01.15.57 ha dhe parcela kadastrale nr. 0229-0, në sipërfaqe prej 0.29.39 ha, Zona Kadastrale Bob.

II.

Me këtë Vendim, obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit ti bëjë ndryshimet kadastrale në RDPP.

III.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria për Arsim dhe Kulturë.

V.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik, na u ka drejtuar me Propozim Vendim 01Nr. 16-9094/2014 -Për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë shoqërore-Shoqëria Sportive "Lepenci", në Kaçanik, në të cilën pasuri me Vendim të Kuvendit të Komunës është caktuar Lokacioni për ndërtimin e Palestrës Sportive. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më 31.03.2014, uke u nisur nga arsyetimet e ekzekutivit të komunës së trashëguese e pronës në fjalë është komuna e Kaçanikut, se është në interes publik të bëhet bartja e të drejtës së shfrytëzimit të Pasurisë Shoqërore -Shoqëria Sportive "Lepenci" në Kaçanik në Pronë Komunale - Drejtoria për Arsim dhe Kulturë në Kaçanik-pasuria e paluajtshme e përcaktuar si në pikën I. të Vendimit, pasiqë ndërtimi i palestrës sportive është në interes të veçantë për qytetarët e komunës me qëllim të funksionimit normal të saj, Kuvendi i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi